




REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA/  
REPUBLIC OF KOSOVO



KOMUNA SHTIME/ OPSTINA-STIMLJE/ MUNICIPALITY OF SHTIME  
ZYRA E KRYETARIT/KANCELARIJA PREDSEDNIKA/MAYOR'S OFFICE

24/06/2024

Nr. i Protokollit: 02/ 688

## Procesverbal nga dëgjimi publik me banorët e Lagjes së Pajtimit

E enjte, më 13 qershor 2024

Kohëzgjatja e takimit: 16:12 – 17:00

Vendi i takimit: SHF "Emin Duraku"

Pjesëmarrës në takim ishin: Kryesuesi i Kuvendit - Adnan Ademi, Drejtori i Drejtorisë Për Shërbime Publike – Bardhyl Rushiti, Drejtori i Drejtorisë për Bujqësi – Gojart Bajrami, Drejtori i Drejtorisë për Buxhet dhe Financa – Besnik Ahmeti si dhe Asambleisti Besnik Seferi.

Rendi i ditës:

### 1. Korniza Afatmesme Buxhetore 2025-2027

Këtë takim e hapi Kryesuesi i Kuvendit të Komunës së Shtimes z.Adnan Ademi i cili së pari i përshëndeti të pranishmit dhe i falenderoi për kohën që kanë gjetur që sot të jenë pjesë e këtij takimi. Ai më pas vazhdoi të tregoi rëndësinë e këtij takimi, ku tha se ky takim ka të bëjë me buxhetin, do të thotë me Kornizën afatmesme Buxhetore për vitin 2025-2027.

Z. Ademi shtoi se ne sot jemi këtu për të marr kërkesat e qytetarëve të Lagjes së Pajtimit, që më pas ato kërkesa të bëhen pjesë e Buxhetit të Komunës dhe vitin tjetër të realizohet. Më tutje z.Ademi tha se është e rëndësishme që sot në këto dëgjime publike të bëhen kërkesat primare të cilat i keni si vend jo të mendoni vetëm për vetë po për tërë lagjen të cilën e përfaqësoni. Ai tha se edhe në vitin paraprak ne kemi qenë në çdo fshat dhe njësoj kemi marrë kërkesat nga banorët e fshatit ku tani ato kërkesa janë bërë pjesë e buxhetit, disa tani më të përfunduar e disa të tjera në procedura e sipër, prandaj edhe këtë vit është e njëjta gjë.

Kryesuesi i Kuvendit, për banorët e Lagjes së Pajtimit dha sqarime sa i përket Kornizën Afatmesme Buxhetore duke thënë se ne e dim që në të gjitha fshatrat e Komunës së Shtimes ka nevoj për shumë investime ku e njëjta gjë vlenë edhe për Lagjen e Pajtimit, mirëpo ne nuk mund ti kalojmë limitet Buxhetore, prandaj duhet që t'i bëjmë secilat investime me radhë.

Ai me tutje vazhdoi duke thënë se për këtë vit buxheti ka një rritje prej afro 1 milion, ku dha sqarime se vitin e kaluar ka qene 10 milion ndërsa këtë vit është afër 10 milion e 800 mij, ku gjysma apo 50% e këtij buxheti shkon në paga dhe mëditje për të gjitha institucionet e Komunës, duke përfshirë Administratën, Arsimin, Shëndetësinë etj, pastaj një pjesë e buxhetit shkon në mallra dhe shërbime, shpenzimet komunale të cilat janë, subvencionet edhe investimet kapitale siç janë asfaltimet, ndriqimet, trotuaret, kanalizimet etj. Z.Ademi shtoi se për komunën e Shtimes është një lajm i mirë që buxheti po rritet çdo vit, por po ashtu duhet pasur parasysh që edhe ka më

shumë shpenzime sa i përketë pjesës së pagave pasi që është rritur koeficienti nga Qeveria Kurti dhe tani secili punëtorë e ka minimalisht pagën 50 euro më shumë, por sduhet harruar që ne sot këtu jemi për investimet kapitale, ku në Komunën e Shtimes edhe këto kanë një rritje, afro 400 mij euro. Prandaj është e rëndësishme që ju ni banorë t'i ngrisi kërkesat e juaja që ne t'i marrim ato sot.

Kërkesat e banorëve të fshatit :


- Ymer Bajrami: Të asfaltohet një segment i rrugës “Camëria”, po ashtu edhe kanalizimi të rregullohet në këtë rrugë. Shtyllat elektrike, të bëhet një kërkesë që të ndërrohen.
- Besnik Seferi: Ambientin në të cilin është shkolla ka hapësirë të mjaftueshme prandaj është e rrugës që të bëhet një park ose një mini park. Të rregullohet kanalizimi në të cilin lidhet rruga “Camëria”, po ashtu nga Tranziti deri tek shkolla të rregullohet kanalizimi dhe trotuari. Rivitalizimi i rrugës “Camëria” dhe “Shefket Muhadini”
- Shaban Muhadini: Të rregullohet ndriçimi në tërë fshatin si dhe të bëhet një park tek Xhamia në lagjen “Bislim Ndrecaj”
- Përparim Asllani: Në lagjen “Fazli Grajqefci”, të bëhet trotuari dhe ndriçimi.
- Arlind Misini: Në lagjen “Anton Cetta” të rregullohet ndriçimi dhe të jetë adekuat, në rrugën “Shefket Muhadini”, të bëhet një rreth rrotullim, trotuari të zgjerohet si dhe të mirëmbahen rrugët.
- Betim Bajrami: Të mirëmbahet shkolla dhe të rregullohet, të shtrohet rruga e shkolla nga hyrja deri tek shkolla.

Procesmbajtës,  
Gentiana Mehmeti





REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA/  
REPUBLIC OF KOSOVO



KOMUNA-SHTIME/OPŠTINA-ŠTIMLJE/MUNICIPALITY OF SHTIME

Lista e pjesëmarrësve në dëgjimin publik në Lagjen e Pajtimit  
Date: 13/06/2024

Nr	Emri dhe Mbiemri	Nenshkrimi
1	Perperim Asllani	
2	Habam Muhedin	
3	Arlind Misini	
4	BETIM BAJRAMI	B. Bajram
5	Besnik Sefeni	
6	Ymer Bajrami	
7		
8		
9		
10		
11		
12		
13		
14		
15		
16		
17		